



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr.93, datë 27.07.2020

“PËR

NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 157, DATË 26.12.2019, TË KËSHILLIT BASHKIAK “PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2020-2022 DHE DETAJIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË SË TIRANËS PËR VITIN 2020”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpikat 1.1 shkronja “b”, pika 1.3 shkronja “c” nenit 41, pika 1, neni 54, shkronja “dh”, nenit 55, pikat 3 dhe 6 të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr. 88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, nenit 43 dhe nenit 44, të ligjit nr.9936 datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 540, datë 08.07.2020 të Këshillit të Ministrave “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e rikonstruksionit ose të riparimit të banesave individuale, të njëjstëve të banimit në ndërtesa (pallat) si dhe mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat) në Bashkitë Durrës, Tiranë, Lezhë, Krujë dhe Kavajë”, udhëzimit plotësues nr.2 datë 20.01.2020, të ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020”, udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018, të ministrit të Financave “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, me propozimin e kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

Në vendimin nr. 157, datë 26.12.2019 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2020-2022 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2020”, të ndryshuar, bëhet kjo shtesë:

1. Të miratojë detajimin e shtesës së fondeve të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit ose të riparimit të banesave individuale të Njëstëve të banimit në ndërtesa (pallat) si dhe mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat) në Bashkinë Tiranë në programin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Mbrojtjes Civile sipas pasqyrës nr.1, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale dhe Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njëstëve Administrative dhe Emergjencave Civile, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

K R Y E T A R